

Titulli i lëndës: **Gjuhë e gjallë ballkanike (kroatisht)**

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës shqipe
Titulli i lëndës:	Gjuhë e gjallë ballkanike (kroatisht)
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti IV, semestri VII
Numri i orëve në javë:	2
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Kadire Binaj – Ejupi
Të dhënat kontaktuese:	kadire.binaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Gjuhë e gjallë ballkanike (kursi i gjuhës - niveli A1- A2) është një kurs i gjuhës së dytë i nivelit fillestar A1 - A2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (CEFR), që është një standard ndërkombëtar për përshkrimin e shkathtësive gjuhësore. Në këtë lëndë studentët do të mësojnë sipas udhëzimeve të dhëna nga CEFR-ja dhe do të përvetësojnë aftësi gjuhësore të të dëgjuarit dhe të kuptuarit të gjuhës kroate; komunikimin në të folur dhe prodhimin e të folurit; të lexuarit dhe të shkruarit. Në këtë nivel të njohurive gjuhësore studentët duhet të fitojnë aftësi për të folur për gjëra të zakonshme duke përdorur një fjalor të kufizuar: ata mund ta prezantojnë veten, të shpjegojnë rutinën e tyre të përditshme, dëshirat dhe nevojat, si dhe ata mund të kërkojnë informata në mënyrë të thjeshtë. Ata udhëzohen se si t'i kuptojnë shprehjet dhe fjalët që përdoren shpesh e që kanë të bëjnë me çështje themelore personale dhe të përditshme; të jenë në gjendje të bëjnë bashkëbisedime sociale shumë të shkurtra; të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të lexojnë në mënyrë të pavarur tekste të thjeshta; të gjejnë informatat në tekste më të gjata; të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të shkurtra e të thjeshta.

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të përvetësojnë shkathtësi gjuhësore të një folësi të nivelit fillestar, në mënyrë që ata të mund të vijojnë kursin e gjuhës B1 në semestrin e radhës. Kjo do të thotë që studentëve duhet t'u ligjërohen të gjitha fushat e shkathtësive gjuhësore sipas CEFR-së (të dëgjuarit dhe të kuptuarit e njërës nga gjuhët ballkanike (përkatësisht, kroatishtes); bashkëbisedimi dhe prodhimi i të folurit; lexim dhe shkrim) me një rezultat të kënaqshëm për këtë nivel fillestar të para-ndërmjetëm. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet komunikimit në të folur.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Në fund të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- të kuptojë shprehjet dhe fjalët që përdoren shpesh e që kanë të bëjnë me çështjet themelore personale dhe të përditshme;
- të ketë biseda shumë të shkurtra në gjuhën kroate;
- të kuptojë dhe të lexojë në mënyrë të pavarur tekste të shkurtra e të thjeshta;
- të përvetësojë një vokabular themelor që i mundëson atij/asaj të merret me situata të përditshme me përmbajtje të parashikueshme;
- të përdorë kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme të foljeve bazike;
- të shkruajë në mënyrë të pavarur tekste të shkurtra e të thjeshta.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediary	2	2	4
Konsultime me mësime dhënësin	10 min	15	2.5

Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	10 min	15	2.5
Total			118: 25= 4.72 5ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve të ndryshme. Përmes ligjëratave do të sqarohen çështje të caktuara teorike, për të vazhduar më pas më shumë me pjesën interaktive të ushtrimeve. Gjatë kohës së ushtrimeve studentët do të bëjnë detyra të ndryshme në klasë dhe në shtëpi, do të shkruajnë e përkthejnë tekste të shkurtra, do të komunikojnë me njëri-tjetrin për gjëra të përditshmërisë në gjuhën kroate. Për ta realizuar orën do të përdoren librat e fletoret e punës, por edhe cd e video të ndryshme (filma, muzikë, etj.), përmes të cilave studentët do të kenë mundësi ta dëgjojnë gjuhën kroatë nga folës nativë të saj.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> - Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10% - Detyrat e shtëpisë 10% - Testi i parë 40% - Testi i dytë 40% - Gjithsej 100%
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> - Marica Čilaš-Mikulić, Milvia Gulešić Machata, Dinka Pasini, Sanda Lucija Udier: Hrvatski za početnike 1: udžbenik hrvatskoga kao drugog i stranog jezika, Hrvatska sveučilišna naklada, Zagreb, 2006.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Jasna Barešić, DOBRO DOŠLI 1 - udžbenik i rječnik za učenje hrvatskoga jezika za strance - Jasna Barešić, DOBRO DOŠLI 1 - gramatika i rješenja zadataka za učenje hrvatskog jezika za strance

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
------	----------------------

Java 1:	Prezantimi i silabusit. Alfabeti i gjuhës kroate; Përshëndetjet; Prezantimi; Përemrat vetorë; folja <i>jam</i> ; Gjinia dhe numri i emrave.
Java 2:	Njerëzit dhe profesionet; Formimi i emrave të profesioneve në gjininë femërore; Emrat e nacionaliteteve;
Java 3:	Familja, miqtë dhe të njohurit: folja <i>quhem</i> ; Përemrat pronorë; Përemrat pyetës; Emrat e kafshëve; Shumësi i emrave mashkullorë; Numrat.
Java 4:	Karakteristikat e njerëzve dhe të gjësendeve; Ngjyrat; Mbiemrat posesiv – njëjësi dhe shumësi i tyre
Java 5:	Të dhëna rreth Kroacisë dhe kroatëve - folja <i>kam</i> ; rasa kallëzore e emrave; e tashmja e foljes <i>di</i> ; e tashmja e foljes <i>stërvitem</i> .
Java 6:	<i>Di, dua</i> dhe <i>mundem</i> ; folja modale <i>duhet</i> + infinitivi; folja modale <i>nevojitet</i> + infinitiv ose emër; <i>guxoj, mundem, dëshiroj</i> .
Java 7:	Folja <i>shkoj</i> ; kallëzorja me parafjalët <i>u</i> dhe <i>na</i> ; ditët e javës; kallëzorja me parafjalët <i>za</i> dhe <i>po</i> ; përemrat vetorë në rasën kallëzore.
Java 8:	Testi i dytë
Java 9:	Folja <i>pi</i> dhe <i>ha</i> ; shijet; ushqimet.
Java 10:	Veshjet: rrobat, këpucët dhe të tjerat; e tashmja e foljes <i>vesh</i> ;
Java 11:	Ku jetojmë?: emrat me përdorimin lokativ; foljet me –ovati, -evati, -ivati; muajt e vitit.
Java 12:	Ku keni qenë?: e kryera e foljes <i>jam</i> , trajta mohuese e saj dhe trajta pyetëse; e kryera e foljeve me – <i>jeti</i> ; e kryera e foljes <i>shkoj, them, mundem</i> .
Java 13:	Udhëtimi: dativi i emrave në njëjës e shumës; trajtat e futurit.
Java 14:	Dhuratat: folja <i>dërgoj</i> dhe <i>shkruaj</i> ; festat; funksionet e dativit
Java 15:	Testi i dytë

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimeve dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.